

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX 660

Suva mbushëse e ashpër me bazë çimento-gëlqere



Fushat e përdorimit

Suva mbushëse me kokrrizim të madh për fasada dhe muret e brendshme mbi të gjitha bazamentet normale. Suvaja e poshtme e përshtatshme për të gjitha llojet e bazamenteve si tulla të plota, tulla me vrimë, blloqe çimentoje, gurë ranor - gëlqeror. Suva mbushëse për RÖFIX fino, plastike dhe strukturore, suva me bazë silikat, silikon ose akrilike. Të mos përdoret në zonën e xokolaturës dhe në zonat në kontakt me ujë. Lëndë ndërtimi minerale sipas shtojcës A të katalogut për masat ekologjike për kërkesat në ndërtimin e shtëpive

Karakteristikat

- Përpunim i shkëlqyer

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	21842
EAN	9003304218424
Paketimi	
Sasi për njësi	30 kg/Nj.
Njësi për paletë	42 Nj./Pal
Madhësia e kokrrizave	0-4 mm
Konsumi	rreth. 1,5 kg/m ² /mm
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.
Reaksioni ndaj zjarrit	A1
Difuzioni i avullit të ujit	rreth. 35
Forca në shtypje	4 N/mm ² (28 d) EN 1015-11
Forca në përkulje	≤ 1,5 N/mm ²
Përcjellshmëria termike	rreth. 0,82 W/mK për P=50% EN 1745:2002 rreth. 0,89 W/mK für P=90% EN 1745:2002
Moduli-E	rreth. 6000 N/mm ²
Grupi i ngarkesës	përfshirë deri W3 B 3346
Masa vëllimore e llaçit të freskët	rreth. 1800 kg/m ³
Trashësia minimale e suvasë	10 mm

RÖFIX 660

Suva mbushëse e ashpër me bazë çimento-gëlqere

Numri i artikullit	21842
Grup llaçi	GP EN 998-1 CS II EN 998-1 Wc0 EN 998-1 PII DIN 18550
Vlera e pH	12
Dendësia e shtresës niveluese	rreth. 1500 kg/m ³ EN 1097-3
Kapaciteti termik	rreth. 1 kJ/kg K
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	rreth. 1671 kg/m ³
Temperatura e nënshtresës	5 °C
Këshilla për paketimin	Në thasë letre me mbrojtje kundër lagështisë.

Baza e materialit

- Pa dispersion plastike
- Rërë gëlqerore e thërrmuar me cilësi të lartë
- Gëlqere e pashuar
- Mineral
- Çimento
- Aditivë për përmirësimin e vetive të përpunimit

Kushtet e punimit

Gjatë fazës së përpunimit dhe tharjes, ambjenti përreth sikurse dhe temperatura e bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C dhe të ngrihet mbi +30 °C. Gjatë përpunimit dhe fortësimit të materialit mbrojeni të paktën gjatë tre ditëve nga ngrirja.

Bazamenti

Bazamenti duhet të jetë i thatë, pa pluhura, pa ngrica, absorbues, i niveluar, me aftësi thithëse dhe mbajtëse, i lirë nga myqet dhe substanca ndarëse si yndyrnat etj. Testimi i bazamentit duhet të vijoje sipas ÖNORM B3346 ose DIN 18350 ose SIA V242. Këshillat e përpunimit vlejné për muret e ndërtimit të prodhuara sipas normës dhe me kusht fugat e mbyllura. Fugat e hapura në mur si dhe carjet, duhet të mbyllën paraprakisht me materjalin e përshtatshëm. Në rast bazamentesh kritike (si mure shumë poroze, porobeton, pllaka HWL, blloqe betoni, pllaka XPS- R etj.) duhen marrë

parasysh rregullat e suvatimit RÖFIX si dhe rregullat e përpunimit të prodhuesit.

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Mbas perfundimit te testimit dhe pergatitjes se bazamentit te suvase (mbyllja e te carave, lidhjeve dhe vendeve te demtuara) ne varesi te bazamentit, nje paratrajtim i pershtatshem, eshte i nevojshem. Bazamentet prej suvaje me aftësi të ndryshme thithëse, kanë nevojë për një llaç sprucues RÖFIX CalceClima®, mbi të gjithë sipërfaqen. Suvaja duhet të aplikohet e freskët mbi të freskët mbi RÖFIX Betonkontakt dhe RÖFIX AI 622. Sipërfaqet e lëmuara të betonit duhet të para-sprucohen me RÖFIX 670-S llaç special sprucues (koha e qëndrimit min. 3 ditë) ose të para-trajtohet me RÖFIX 12 urë lidhëse (koha e qëndrimit min. 24 orë). Para fillimit te suvatimit, ne te gjitha cepat duhet te jene vendosur profile suvaje te pandryshkur. Për vendosjen e profileve të suvasë tek suvatë me bazë çimento, në asnjë rast nuk duhet të përdorni llaç me përmbajtje gipsi! Profilet e aluminit nuk duhet të përdoren për shkak të paqëndrueshmërisë në zona alkalike .

Përgatitja

Në aplikimin me dorë një thes përziheni sipas raportit me ujë të pastër duke përdorur një mikser ose përzierës mekanik derisa të arrini një masë homogjene. Koha e përzierjes në rast përzierje me dorë 2 deri 3 minuta.

ROFIX 660

Suva mbushëse e ashpër me bazë çimento-gëlqere

Këshilla për përpunimin

Llaçin e freskët punojeni brenda 2 orëve. Gjatë tharjes duhet të përdorni mjete për ngrohjen- që të krijohen kushte më të mira për tharjen dhe fortësimin (psh. me ventilues). Ngrohja e drejtpërdrejtë e suvasë nuk është e lejuar. Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Në raste kushtesh të pafavorshme atmosferike (nxehhtësi, erë e forë) ose në rast se kemi bazamente me aftësi të lartë thithëse, bazamentin trajtoheni me ujë. Koha e maturimit e suvasë mbushëse para shtresës përfundimtare, rreth 1 ditë për mm trashësi suvaje.

Përpunimi

Në rast përpunimi me dorë, materialin e perzierë shtojeni me mistiri apo vegël tjetër të përshtatshme. Në aplikimin e makineri sprucojeni me pompën e suvasë. Mbas shtrimit, tendoseni me mastar njëtrajtësisht. Mbas ngurtësimit, kruajeni, punojeni ose ashpërsoheni me Rabbot duke e përgatitur për shtesën e mëpasshme. Vecanërisht gjatë ngrohjes duhet bërë kujdes për përmirësimin e kushteve të tharjes dhe për ajrim të mjaftueshëm. Shtresëzim me bazë gips apo me dispersion, gjithashtu pllakat lejohet të shtrohen vetëm mbas tharjes së plotë të suvasë së poshtme- minimumi mbas 4 javësh. Sipërfaqet e rrjedhshme nuk kanë nevojë të jenë të lëmuara (vëreni Normën ÖNORM B 2207).

Magazinimi

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit min. 12 muaj, sipas Rregullores 1907/2006/EG Aneksi XVII në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambjenti. Datën e prodhimit shiheni mbi etiketë.

Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në veteve nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.